



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 629/4 prot.

Elbasan, me 06.03.2021

VENDIM

Nr 12 datë 06.03.2021

PËR

**ULJE TARIFE VJETORE E SHKOLLIMIT TË STUDENTËVE NË CIKLIN E DYTË TË
STUDIMEVE, PËR PROGRAM TË PARË STUDIMI, PËR VITIN AKADEMIK 2020-2021**

Në mbështetje të nenit 47 dhe 49 të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM-së Nr. 780, datë 26.12.2018 "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programet e ciklit të dytë të studimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë", VBA nr 49 datë 20.11.2020 "Për procedurën e shqyrtimit dhe miratimit të uljes së tarifës vjetore të shkollimit të studentëve të Ciklit të dytë të studimeve, për program të parë studimi për vitin akademik 2020-2021", Relacionit të Administratorit "Për ulje tarife vjetore e shkollimit të studentëve në ciklin e dytë të studimeve, për program të parë studimi, për vitin akademik 2020-2021", Bordi i Administrimit në mbledhjen në mbledhjen Tij të datës 06.03.2021,

VENDOSI:

- 1- Përfitojnë ulje tarife shkollimit 5 studentë me rezultate të konfirmuara nga sekretaritetë mësimore, që vazhdojnë studimet në vitin e parë e të dytë brenda kohëzgjatjes normale, sipas listës bashkëlidhur dhe 1 student i shkëlqyer (me mesatare 10 në programin e parë të studimit).
- 2- Përfitojnë ulje tarife vjetore e shkollimit 265 studentë me kriteret të tjera, që vazhdojnë studimet në vitin e parë e të dytë brenda kohëzgjatjes normale, sipas listës bashkëlidhur.
- 3- Nuk përfitojnë ulje tarife vjetore e shkollimit 58 studentë me kriteret të tjera, sipas listës bashkëlidhur.
- 4- Ngarkohet Administratori i Universitetit me zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BORDIT
ARDIAN DURMISHI

